



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
USTAVNI SUD  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 18 prill 2023  
Ref.nr: RK 2153//23

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI102/22**

Parashtrues

**Faton Aliu**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [Rev. nr. 559/2022] të 10 marsit  
2022 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe  
Enver Peci, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga Faton Aliu, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga Naim Haliti, avokat nga Prishtina.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [Rev. nr. 559/2022] e 10 marsit 2022 (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi i kontestuar) të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).
3. Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 11 prill 2022.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6.1 [E drejta për një proces të rregullt] dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 [Mbrojtja e Pronës] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 5 korrik 2022, kërkesa u dorëzua në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme Gjykata).
7. Më 12 korrik 2022, Gjykata për regjistrimin e kërkesës e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.
8. Më 25 korrik 2022, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR. KI102/22, caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi Peci gjyqtare raportuese dhe me Vendimin KSH.KI102/22, caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban (anëtarë).
9. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
10. Më 5 prill 2023, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

11. Më 15 prill 2011, parashtruesi i kërkesës lidhi kontratën e punës me Limak Kosovo International Airport J.S.C. "Adem Jashari" (në tekstin e mëtejme: punëdhënësi). Kontrata e punës ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe punëdhënësit, ishte lidhur për periudhë të caktuar kohore, përkatësisht nga 4 prilli 2011 deri më 3 prill 2015. Nëpërmjet një amendamenti të shtuar, punëdhënësi dhe parashtruesi i kërkesës nënshkruan vazhdimin e kontratës edhe për një vit tjetër, respektivisht deri më 4 prill 2016.

12. Më 28 tetor 2015, Komisioni disiplinor në kuadër të punëdhënësit, mbajti seancë dëgjimore për të vërtetuar dyshimet për shkelje të rënda disiplinore ndaj parashtruesit të kërkesës dhe punëtorëve (Xh.H), (B.Sh), (V. A), dhe (B. K).
13. Më 6 nëntor 2015, Komisioni disiplinor i punëdhënësit, ia paraqiti raportin me rekomandime Drejtorit të Përgjithshëm të Punëdhënësit për masat disiplinore të ndërmarra ndaj parashtruesit të kërkesës dhe katër punëtorëve të lartcekur. Propozimi i komisionit ishte që të gjithë punëtorëve t'u ndërpritet marrëdhënia e punës, për shkak të shkeljeve të rënda disiplinore të konstatuara.
14. Më 10 nëntor 2015, punëdhënësi me Vendimin [HR.2015-0693/10] ia ndërpreu marrëdhënien e punës parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin, si në vijim: *“Nëpunësit Faton Aliu, arkëtar në parking, i ndërpritet marrëdhënia e punës për shkelje të rëndë – sjellje e keqe në punë dhe shkelje të detyrimeve, të kryera me datë 23 shtator 2015 në vend të punës”*.
15. Më 11 nëntor 2015, parashtruesi i kërkesës e pranoi vendimin e lartcekur të punëdhënësit, ndaj të cilit më pas parashtrroi kërkesëpadi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, dega në Lipjan (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore), nëpërmjet së cilës kërkoi: (i) kthim në vendin e punës dhe (ii) kompensim të pagave të porealizuara si rezultat i ndërprerjes së marrëdhënies së punës.
16. Më 17 korrik 2017, Gjykata Themelore, me Aktgjykimin C. nr. 51/2017, (i) aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës; (ii) detyroi punëdhënësin, që në emër të dëmit material t'ia kompensojë parashtruesit të kërkesës shumën prej 2.653.88 euro, si shpërblim për mosrealizimin e pagave për periudhën 10 nëntor 2015 deri më 4 prill 2016; dhe (iii) refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës për kthimin në vendin e punës. Gjykata Themelore, ndër të tjera, vlerësoi që gjatë mbledhjes së Komisionit disiplinor nuk kishte marrë pjesë përfaqësuesi i sindikatës së pavarur të punëdhënësit dhe as përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës. Sipas Gjykatës Themelore, vendimi për largim nga puna nuk kishte saktësuar kohën dhe vendin e shkeljes, si dhe as mënyrën dhe veprimet e parashtruesit të kërkesës që e kanë bërë këtë të fundit përgjegjës dhe fajtor për shkelje të detyrave të punës. Në lidhje me kërkesën e dytë, Gjykata Themelore vlerësoi se parashtruesi i kërkesës nuk mund të kthehej në vendin e punës, për shkak se në momentin e marrjes së Aktgjykimit [C. nr. 51/2017], tashmë kishte skaduar kontrata e tij e punës.
17. Më 9 tetor 2017, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktgjykimit të 17 korrikut 2017 të Gjykatës Themelore, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Nëpërmjet kësaj anekse parashtruesi i kërkesës kërkoi që pika I (një) e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të vërtetohej, ndërsa pika II (dy) e Aktgjykimit, të ndryshohej dhe të miratohej kërkesa e tij për kthimin në punë.
18. Ndaj, Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, ankesë kishte parashtruar edhe punëdhënësi, me propozimin që kërkesëpadija e parashtruesit të kërkesës të refuzohej në tërësi si e pabazuar.
19. Më 1 korrik 2020, Gjykata e Apelit, me Aktgjykimin Ac. nr. 4851/2017, përkritazi me ankesat e punëdhënësit dhe të parashtruesit të kërkesës vendosi, si më poshtë:
  - I. Aprovohet ankesa e punëdhënësit, dhe ndryshohet Aktgjykimi i 17 korrikut 2017 i Gjykatës Themelore, duke gjykuar si në vijim: (i) Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadija e parashtruesit të kërkesës, me të cilin kishte kërkuar anulimin e Vendimit [HR.2015-0693/10] të 10 nëntorit 2015 të punëdhënësit; refuzohet

kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës përkitazi me kërkesën për kompensimin e shumës prej 2,653.88 euro, të kërkuar në emër të shpërblimit të dëmit për mospagesën e pagave për periudhën 10 nëntor 2015 - 4 prill 2016, me kamatë ligjore prej 8% (tetë përqind); shumën prej 132.63 euro, të kërkuar në emër të kontributeve pensionale; shumën prej 139.82 euro, të kërkuar në emër të tatimit në pagë, si dhe shumën prej 699.60 euro, të kërkuar në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore, të gjitha në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dorëzimi i Aktgjykimit.

II. Refuzohet si e pabazuar ankesa e parashtruesit të kërkesës, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore, në pikën II (dy) të dispozitivit, me të cilin ishte refuzuar kërkesëpadia për kthim në punë, vërtetohet.

20. Gjykata e Apelit ndër të tjera, arsyetoi se “... qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes (si në pikën I, të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar) nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që përkundër faktit se aktgjykimi i atakuar rezultoi të mos jetë i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe as me shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore sipas pretendimeve ankimore të palës ankuese, sipas kësaj gjykate gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, nuk korrespondon drejtë me provat nga shkresat e lëndës, ku për pasojë me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar ka pasur zbatim të gabuar të së drejtës materiale, pasi që gjykata ankimore me anë të vlerësimit ndryshe të shkresave dhe provave të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit kryesor nga gjykata e shkallës së parë, konstaton një gjendje tjetër faktike nga ajo e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, mbi bazën e së cilës gjendje faktike, kjo gjykatë vjen në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, me çka në këtë rast ka kushte që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet, ku edhe u vendos si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi. [...] Nga interpretimi i dispozitave ligjore të Rregullores për Procedurën Disiplinore dhe të ankesave, neni 5, paragrafët 4 dhe 5, të Kontratës së Punës së datës 01.12.20104, dhe neni 70, paragraf 1, pika 1.4 dhe 1.4.1 të Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212 dhe nga shqyrtimi i të gjitha provave dhe shkresave të lëndës Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pabazuar”.
21. Më 24 shtator 2020, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit të 1 korrikut 2020 të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Nëpërmjet kërkesës për revizion parashtruesi i kërkesës kërkoi prishjen e aktgjykimeve të Gjykatës Themelore dhe të Apelit, dhe aprovimin në tërësi të kërkesëpadisë së tij, që nënkupton edhe kërkesën për kthim në punë. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës në mbështetje të pretendimeve të tij i është referuar Aktgjykimit [Rev. nr. 54/2018] të 12 prillit 2018, të vet Gjykatës Supreme, me të cilin kjo e fundit kishte vërtetuar vendimet e shkallës së parë dhe të dytë për: (i) anulimin e Vendimit [HR.2015-0693/10] të 10 marsit 2015 të punëdhënësit; (ii) kthimin në vendin e punës, dhe (ii) kompensimin e pagave të parealizuara, për punëtorin B. Sh., në rrethana të njëjta faktike dhe juridike.
22. Më 10 mars 2022, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin [Rev. nr. 559/2022], aprovoi pjesërisht revizionin e parashtruesit të kërkesës; ndryshoi pikën I (një) të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, duke lënë në fuqi pikën I (një) të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore; dhe refuzoi si të pabazuar kërkesën për revizionin, të ushtruar kundër pikës II (dy) të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.

23. Në lidhje me kërkesën për revizionin, Gjykata Supreme kishte analizuar dhe trajtuar dy çështje kryesore: e para, kërkesën e parashtruesit të kërkesës për kompensimin e pagave për periudhën 10 nëntor 2015 deri më 4 prill 2016; dhe e dyta, kërkesën për kthim në vendin e punës. Në lidhje me çështjen e parë, Gjykata Supreme konstatoi shkelje ligjore në vendimin e punëdhënësit, duke arsyetuar *“se këto shkelje, vendimin e kontestuar të paditurit e bëjnë të paligjshëm, andaj i njëjti anulohet, dhe paditësit i takojnë të ardhurat personale lartësia e të cilave është konstatuar nga eksperti gjyqësor financiar A.G., nga Prishtina, deri më datën kur ka pasur afatshmëri kontrata e punës së paditësit”*. Në lidhje me çështjen e dytë, përkatësisht për kërkesën për kthim në vendin e punës, Gjykata Supreme e refuzoi si të pabazuar kërkesën për revizion, nga shkak se në momentin e marrjes së Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, kontrata e punës e lidhur mes punëdhënësit dhe parashtruesit të kërkesës veçse kishte skaduar më 4 prill 2016, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore është marrë më 17 korrik 2017. Gjykata Supreme, tutje vlerësoi se *“në rastin konkret, edhe pas skadimit të kontratës së punës nuk mund të detyrohet ligjërisht i padituri që punëtorin ta kthej në punë dhe detyra të punës të cilat i ka punuar më parë sipas asaj kontrate. Gjykata askujt nuk mund t’ia vazhdoj kontratën e punës, atë e bën punëdhënësi, kështu që revizioni i paditësit në këtë drejtim vlerësohet si i pabazuar...”*.
24. Përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se Gjykata Supreme në rastin e B. Sh, kishte vendosur ndryshe me Aktgjykimin e saj [Rev. nr. 54/2018] të 12 prillit 2018, kjo e fundit theksoi: *“... paditësi pa të drejtë thirret në aktgjykimin e lartpërmendur të kësaj gjykate edhe për kthim në punë, Rev.nr.54/18 datë 12.04.2018, ngase, përveç tjerash, nuk mund të thuhet se rasti i trajtuar me këtë aktgjykim është plotësisht i njëjtë me rastin konkret, për të cilën arsye, në këtë drejtim gjykata e revizionit konsideron se nuk ka trajtim jo të barabartë para ligjit, dhe para kësaj gjykate të paditësit me punëtorin tjetër të cilit i referohet ky aktgjykim”*.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon që Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme ka shkelur të drejtat e tij kushtetuese, të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 [E Drejta për një proces të rregullt] të KEDNj-së, nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 [Mbrojtja e Pronës] të KEDNj-së.
26. Parashtruesi i kërkesës në këtë drejtim pretendon që *“Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, nuk është gjykim i drejt për faktin se kjo gjykatë për të njëjtën bazë materiale si të parashtruesit, kolegun e tij të punës e kthen në punë me kompensim dhe me këtë gjykim gjykata e revizionit shihet se ka trajtuar ndryshe parashtruesin e kërkesës për dallimin nga kolegu i tij i punës, të cilët janë larguar nga puna me baza të njëjta procedurale dhe faktike dhe ligjore, e që kjo bie ndesh me të drejtat kushtetuese të dispozitave të cekura, e cila e drejtë është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës”*.
27. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *“Gjykata Supreme me aktgjykimet e saj, gjykon se vendimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës nga punëdhënësi është i kundërligjshëm kundër tani parashtruesit dhe kolegut të tij të punës, kjo gjykatë me aktgjykimin e saj tani parashtruesit i refuzohet kthimi në punë dhe i vendoset kompensim deri në afatin e kontratës së punës, kurse kolegun e tij me aktgjykim e kthen në punë. Si parashtruesi dhe kolegu i punës kishin kontratë të punës me afat të njëjtë deri me datën 04 prill 2016”*.

28. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon që Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, kanë vendosur ndryshe për kolegun e tij të punës, B. Sh., për të cilin kishin vendosur kthimin në punë, ndërsa në rastin e tij kishin vendosur për moskthim në punë, përkundër faktit që të gjitha rrethanat dhe faktet e rastit të tij kanë qenë të njëjta me rastin e B. Sh-së. Sipas, parashtruesit të kërkesës “*provat e bashkëngjitura të parashtruesit dhe të kolegut të tij, argumentojnë se gjykimet për të njëjtat prova dhe procedurë vendosin gjykime të ndryshme dhe të paharmonizuara*”.
29. Në mbështetje të pretendimeve të tij parashtruesi i kërkesës i referohet edhe rastit të Gjykatës KI138/15, ku Gjykata kishte konstatuar “... *se mungesa e adresimit të plotë të pretendimeve dhe dhënia e përgjigjes adekuate në tri pretendimet bazike të parashtruesit si: legjitimiteti pasiv i palës në procedurë, çështja e procedurës disiplinore ndaj të punësuarit dhe aplikimi tërësisht i gabuar i ligjit, si çështje thelbësore të procesit, përbëjnë një të metë të pakapërcyeshme të përmbajtjes së Aktgjykimit dhe arsytimit të Gjykatës*”.
30. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata të shpallë të pranueshme kërkesën e tij; të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme dhe të kthejë çështjen në rigjykim.

## **Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore**

### **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**

#### **Neni 24**

#### **[Barazia para Ligjit]**

1. *Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
2. *Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*
3. *Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.*

#### **Neni 31**

#### **[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

1. *Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
2. *Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*
3. *Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieeve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.*
4. *Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.*

5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

**Neni 46**  
**[Mbrojtja e Pronës]**

[...]

3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet.

[...]

**Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut**

**Neni 6**  
**(E drejta për një proces të rregullt gjyqësor)**

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohe shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

[...]

**LIGJI I PUNËS Nr. 03/L-212**

**Neni 70**  
**(Ndërprerja e Kontratës së Punës nga ana e punëdhënësit)**

1. Punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit me një periudhë paralajmërimi, atëherë kur:
  - 1.1. ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike ose organizative;
  - 1.2. i punësuari nuk është më i aftë t'i kryejë detyrat e punës;
  - 1.3. punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në rrethanat e përcaktuara në nënparagrafin 1.1. dhe 1.2., të këtij paragrafi nëse është e papërshtatshme për punëdhënësin që ta transferojë të punësuarin në një vend pune tjetër, ta trajtojë a ta kualifikojë atë për ta kryer punën ose ndonjë punë tjetër;
  - 1.4. punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit në periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes në:
    - 1.4.1. rastet e rënda të sjelljes së keqe të punonjësit; dhe
    - 1.4.2. për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës.
  - 1.5. punëdhënësi duhet ta njoftojë të punësuarin për largimin e tij/saj menjëherë pas rastit që shpie në largim, ose sapo punëdhënësi të jetë vënë në dijeni të atij rasti;
  - 1.6. punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit pa periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes, atëherë kur:

1.6.1. i punësuarit është fajtor për përsëritjen e një keqsjelljeje më pak serioze ose të shkeljes së detyrimeve;

1.6.2. performanca e të punësuarit mbetet e pakënaqshme përkundër paralajmërimit me shkrim.

2. Punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në bazë të nënparagrafit 1.6. të paragrafit 1. të këtij neni vetëm atëherë kur i punësuarit ka marrë përshkrimin në formë të shkruar të performancës së pakënaqshme, një afat të përcaktuar kohor brenda të cilit i punësuarit duhet ta përmirësojë performancën e vet, si dhe një deklaratë se dështimi për përmirësimin e performancës do të rezultojë me largim nga puna pa asnjë paralajmërim të mëtejshëm me shkrim.

3. Punëdhënësi duhet që të mbajë takim me të punësuarin për t'ia shpjeguar atij/asaj ndërprerjen e kontratës së punës ose me qëllim që t'ia dorëzojë paralajmërimin, i punësuarit ka të drejtë që të shoqërohet nga një përfaqësues sipas dëshirës së vet.

4. Marrëveshjet Kolektive ose Aktet e Brendshme të Punëdhënësit mund t'i specifikojnë llojet e keqsjelljeve ose të shkeljeve të detyrimeve të cilat bëjnë që i punësuarit t'i nënshtrohet ndërprerjes të kontratës së punës pa periudhë paralajmërimi, qoftë pas një rasti të vetëm dhe qoftë pas shkeljeve të përsëritura.

## **Neni 72**

### **(Procedura para ndërprerjes së Kontratës)**

1. Vendimi për të ndërprerë kontratën e punës duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të përfshijë arsyetimin për ndërprerje.

2. Vendimi nga paragrafi 1. i këtij neni është përfundimtar ditën kur i dorëzohet të punësuarit.

3. Punëdhënësi është i obliguar të bëjë pagesën e pagës dhe të ardhurave të tjera, deri në ditën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

4. Punëdhënësi mund t'i ndalojë qasjen punonjësit në objektin e ndërmarrjes gjatë periudhës së njoftimit, përkatësisht para ndërprerjes së kontratës së punës.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

31. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

#### **Neni 113**

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

33. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen më tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:



Neni 47  
[Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

Neni 49  
[Afatet]

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht ...”.*

34. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; ai konteston kushtetutshmërinë e një akti të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev. nr. 559/2022] të 10 marsit 2022 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe kërkesën e ka parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, siç parasheh neni 49 i Ligjit.
35. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht me nënrregullin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, që përcakton:

Rregulli 39  
[Kriteret e pranueshmërisë]

[...]

*(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk e mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*

[...]

36. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e

Kushtetutës dhe KEDNj-së (shih, rastin e GjEDNj-së [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih, rastin e Gjykatës [Kl166/20](#), parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, rastet e GjEDNj-së, [Kemmache kundër Francës](#), nr. 17621/91, Aktgjykimi i 24 nëntorit 1994, kategoria (i), [Juta Mentzen kundër Lituanisë](#), nr. 71074/01, vendimi i 7 dhjetorit 2004, kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii).

37. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës kishte lidhur kontratë pune me punëdhënësin, në kohë të caktuar, përkatësisht nga 4 prilli 2011, deri më 3 prill 2015, e cila ishte vazhduar nga punëdhënësi edhe për një vit, përkatësisht deri më 4 prill 2016. Më 6 nëntor 2015, punëdhënësi kishte formuar një komision disiplinor, për të shqyrtuar pretendimet për shkelje disiplinore ndaj parashtruesit të kërkesës dhe disa punëtorëve tjerë që dyshoheshin për shkelje të rënda disiplinore. Pas mbajtjes së seancave disiplinore Komisioni i kishte rekomanduar punëdhënësit që të pesë (5) punëtorëve pa përjashtim t'u ndërpritej kontrata e punës për shkak të “sjelljeve të këqija dhe shkeljes së obligimeve të punës”. Kundër, vendimit për largim nga puna, parashtruesi i kërkesës kishte ushtruar kërkesëpadi në Gjykatën Themelore, nëpërmjet së cilës kishte kërkuar kompensimin e pagave të porealizuara, nga momenti i largimit e deri në momentin e kthimit në vendin e punës. Gjykata Themelore, me Aktgjykimin e 17 korrikut 2017, kishte aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe atë vetëm përkitazi me (i) kërkesën për kompensim të pagave të paralizuar, duke refuzuar atë përkitazi me (ii) kërkesën për kthim në vendin e punës. Ky Aktgjykim u apelua nga punëdhënësi dhe po ashtu edhe nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatën e Apelit, e cila me Aktgjykimin e 1 korrikut 2020 konfirmoi aktgjykimin e shkallës së parë për mos aprovim të kërkesëpadi së për (i) kthim në vendin e punës, dhe (ii) vërtetoi kërkesëpadinë për kompensim të pagave të porealizuara, deri në skadimin e kontratës së punës. Kundër këtij aktgjykimi parashtruesi i kërkesës ushtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, duke kërkuar aprovimin e kërkesëpadi së në tërësi edhe për sa i përket kthimit në punë, sikurse kjo e fundit kishte vendosur për kolegun e tij të punës B. Sh. Më 10 mars 2022, Gjykata Supreme me Aktgjykimin e kontestuar, e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, duke lënë në fuqi aktgjykimet e instancave më të ulëta, sa i përket (i) kompensimit të pagave të porealizuara, deri në skadimin e kontratës së punës, por duke refuzuar kërkesëpadinë e tij sa i përket (ii) kërkesës për kthim në punë.
38. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, shkel të drejtat e tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, dhe nenin 6.1 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNj-së.
39. Nga shkresat e lëndës, dhe nga mënyra e arsyetimit të pretendimeve në kërkesë, Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me vendosjen ndryshe të dy rasteve me rrethana të njëjta faktike dhe juridike nga ana e Gjykatës Supreme. Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se pretendimi i parashtruesit të kërkesës në të vërtetë ngre çështje të mos konsistencës së praktikës gjyqësore nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6.1 i KEDNj-së.



40. Andaj, në vazhdim, Gjykata do të analizojë këtë pretendim thelbësor të parashtruesit të kërkesës në pajtueshmëri me standardet e praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë.

**i. Përkitazi me pretendimet për jokonsistencë të praktikës gjyqësore për çështje të njëjta faktike dhe juridike**

*a) Parimet e përgjithshme*

41. Përkitazi me parimet themelore që ndërlidhen me konsistencën e praktikës gjyqësore, Gjykata rikujton se praktika gjyqësore e GjEDNj-së ka rezultuar në katër parime themelore që e karakterizojnë analizën lidhur me konsistencën e praktikës gjyqësore, dhe atë si në vijim: (i) siguria juridike; (ii) nuk ka një të drejtë të fituar për konsistencë të praktikës gjyqësore; (iii) divergjenca nuk është domosdoshmërisht në kundërshtim me KEDNj-në; dhe (iv) përjashtimi i arbitraritetit të dukshëm.
42. Duke iu referuar parimeve të përcaktuara më lart, Gjykata më tej thekson se GjEDNj-ja përdor tri kritere themelore për të përcaktuar nëse një divergjencë e pretenduar përbën shkelje të nenit 6.1 të KEDNj-së, i pari (i), nëse divergjencat në praktikën gjyqësore janë “*të thella dhe afatgjata*” i dyti (ii), nëse ligji vendor përcakton mekanizma të aftë për të zgjidhur divergjenca të tilla; dhe i treti (iii), nëse ata mekanizma janë zbatuar dhe me çfarë efekti (në këtë kontekst, shih rastet e GjEDNj-së, [Beian kundër Rumanisë](#), nr. 30658/05, Aktgjykim i 6 dhjetorit 2007, paragrafët 37 -39; [Famullia Greko-Katolike e Lupenit dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), nr. 76943/11, Aktgjykimi i 29 nëntorit 2016, paragrafët 116 - 135; [Jordan Jordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë](#), nr. 23530/02, Aktgjykim i 2 korrikut 2009, paragrafët 49-50; [Nejdet Şahin i Perihan Şahin kundër Turqisë](#), nr. 13279/05, Aktgjykimi i 20 tetorit 2011, paragrafi 53; dhe shih gjithashtu rastin e Gjykatës, [KI175/20](#), Agjencia Kosovare e Privatizimit, Aktvendimi i 26 marsit 2021, paragrafët 60).
43. GjEDNj, në lidhje me këtë, ka konstatuar se mundësia e vendimeve kontradiktore gjyqësore është një tipar i qenësishëm i çdo sistemi gjyqësor i cili bazohet në një rrjet të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit me autoritet mbi fushën e juridiksionit territorial të tyre. Divergjencat e tilla mund të paraqiten gjithashtu brenda të së njëjtës gjykatë. Kjo, në vetvete, nuk mund të konsiderohet në kundërshtim me KEDNj-në (shih, rastet e GjEDNj-së, [Nejdet Şahin i Perihan Şahin kundër Turqisë](#), cituar më lart, paragrafi 51; [Albu dhe të tjerët kundër Rumanisë](#) dhe 63 (gjashtëdhjetë e tri) kërkesa tjera, Aktgjykim i 10 majit 2012, paragrafi 34; [Santo Pinto kundër Portugalisë](#), nr. 39005/04, Aktgjykim i 20 majit 2008, paragrafi 41; dhe [Famullia Greko-Katolike e Lupenit dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), paragrafi 122; dhe shih gjithashtu rastin e Gjykatës, [KI175/20](#), Agjencia Kosovare e Privatizimit, Aktvendimi i 26 marsit 2021, paragrafi 57).
44. GjEDNj ka theksuar vazhdimisht se, përveç rasteve të arbitraritetit të dukshëm, nuk është detyrë e saj të vë në pikëpyetje interpretimin e ligjit vendas nga ana e gjykatave vendore (shih, për shembull, rastet e GjEDNj-së [Adamsons kundër Letonisë](#), nr. 3669/03, Aktgjykim i 24 qershorit 2008, paragrafi 118; dhe [Nejdet Şahin i Perihan Şahin kundër Turqisë](#), cituar më lart, paragrafi 50) dhe në parim, nuk është funksioni i saj të krahasojë vendime të ndryshme të gjykatave vendore, edhe nëse merren në procedura dukshëm të ngjashme. Ajo duhet të respektojë pavarësinë e gjykatave.



45. Gjykata, në këtë kontekst, tashmë ka një praktikë gjyqësore të konsoliduar për sa i përket çështjeve që ndërlidhen me shkeljen e të drejtës në gjykim të drejtë, si rezultat i praktikës gjyqësore jokonsistente, e cila cenon drejtpërdrejt parimin e sigurisë juridike. (shih, rastet e Gjykatës [KI35/18](#), me parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, dhe [KI87/18](#), me parashtrues *IF Skadeforsikring*, ku Gjykata konstatoi shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, si rezultat i divergjencës në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme, po ashtu shih edhe rastet e Gjykatës, [KI74/19](#), [KI111/19](#), [KI09/20](#) dhe [KI188/20](#), me parashtrues *Suva Rechtsabteilung*, Aktgjykimet e 28 prillit 2021, në të cilat Gjykata në trajtimin e pretendimeve për divergjencë në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme, nuk kishte konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së.

*b) Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret*

46. Në vijim, Gjykata do të aplikojë parimet e elaboruara më lart në rrethanat e rastit konkret, duke aplikuar kriteret mbi bazën e të cilave Gjykata dhe GjEDNj trajton çështjet e divergjencës përkitazi me praktikën gjyqësore, duke filluar me vlerësimin nëse në rrethanat e rastit konkret, (i) divergjencat e pretenduara në praktikën gjyqësore janë “të thella dhe afatgjata”; dhe nëse ky është rasti, (ii) ekzistimin e mekanizmave të aftë për të zgjidhur divergjencën përkatëse; dhe (iii) vlerësimin nëse këta mekanizma janë zbatuar dhe me çfarë efekti në rrethanat e rastit konkret.

47. Referuar pretendimit thelbësor të parashtruesit të kërkesës se Gjykata Supreme ka shkelur të drejtat e tij kushtetuese, sepse ka vendosur ndryshe për dy raste me rrethana të njëjta faktike dhe juridike, duke treguar jokonsistencë në aktgjykimet e saj, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në mbështetje të pretendimeve, iu referua Aktgjykimit [Rev. nr. 54/2018] të 12 prillit 2018 të Gjykatës Supreme, dhe kërkon që rrethanat e rastit të tij të krahasohen me rrethanat e rastit të referuar të Gjykatës Supreme, ku kjo e fundit kishte vendosur për kolegun e punës së tij B. Sh.

48. Gjykata duhet gjithashtu të ritheksojë se, bazuar edhe në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së dhe asaj të Gjykatës nuk është funksioni i saj të krahasojë vendime të ndryshme të gjykatave të rregullta, edhe nëse merren në procedura dukshëm të ngjashme, pasi që pavarësia e tyre duhet të respektohet. (shih, rastin e GjEDNj-së [Adamsons kundër Letonisë](#), cituar më lart, paragrafi 118, shih po ashtu rastet e Gjykatës [KI87/18](#) dhe [KI35/18](#), të cituara më lart).

49. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës lidhur me pretendimet për shkelje kushtetuese të të drejtave dhe lirive themelore si rezultat i divergjencave në praktikë gjyqësore, duhet t’ia paraqesin Gjykatës argumentet përkatëse përkitazi me ngjashmërinë faktike dhe juridike të rasteve të cilat pretendojnë se janë zgjidhur ndryshe nga gjykatat e rregullta, duke rezultuar në vendime kundërthënëse në praktikën gjyqësore dhe e cila mund të ketë rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së. (shih, rastin [KI35/18](#), cituar më lart, paragrafi 76).

50. Bazuar në si më sipër, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në lidhje me rastin B. Sh., të cilit i është referuar thekson nuk ka mundur të siguroj Aktgjykimin [Rev. nr. 54/2018] të 12 prillit 2018 të Gjykatës Supreme, por vetëm Aktgjykimin [Ca. nr. 1519/2017] e 12 dhjetorit 2017 të Gjykatës së Apelit. Megjithatë, Gjykata rikujton se Aktgjykimi [Rev. nr. 54/2018] i 12 prillit 2018 i Gjykatës Supreme ishte objekt vlerësimi në Gjykatë, në rastin [KI109/18](#), me parashtrues: *Limak Kosovo International Airport J.S.C.* Marrë parasysh këtë, Gjykata në vazhdim do të përshkruaj rrethanat faktike të rastit të B. Sh-së, të cilit i është referuar parashtruesi i kërkesës, me pretendimin se rrethanat faktike dhe juridike të dy rasteve janë tërësisht të njëjta.

**Rrethanat faktike të rastit B. Sh., të cilit i referohet parashtruesi i kërkesës**

51. B. Sh. kishte themeluar marrëdhënie pune në kohë të caktuar me punëdhënësin Limak Kosovo International Airport J.S.C., respektivisht nga 4 prilli 2011 deri më 4 prill 2015. Kontrata e punës së B. Sh. ishte vazhduar nga punëdhënësi edhe për një vit, gjegjësisht deri më 4 prill 2016. Më 10 nëntor 2015, Komisioni Disiplinor i punëdhënësit me Vendimin [HR.2015-0693/10], kishte vendosur që B.Sh-së dhe disa punëtorëve tjerë t'u ndërpritet marrëdhënia e punës, me arsyetimin se të njëjtit kishin bërë shkelje të rënda disiplinore. Kundër këtij vendimi B. Sh. më 18 nëntor 2015, kishte parashtruar ankesë pranë Bordit të Ankesave, por që nga ky i fundit theksoi se nuk kishte marrë përgjigje. Në një datë të paspecifikuar, B. Sh. kishte ushtruar padi në Gjykatën Themelore, me të cilën kishte kërkuar (i) anulimin e Vendimit [HR.2015-0693/10] të 10 nëntorit 2015 të punëdhënësit, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, (ii) kthim në vendin e punës, dhe (iii) kompensimin e pagave të porealizuara. Më 11 nëntor 2016, Gjykata Themelore, me Aktgjykimin [C. nr. 511/2015], kishte aprovuar kërkesëpadinë e B.Sh-së, duke e detyruar punëdhënësin që të njëjtin (i) ta kthejë në vendin e punës dhe (ii) t'ia kompensojë pagat e porealizuara. Gjykata Themelore, ndër të tjera kishte arsyetuar se *“me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës nuk ishin respektuar dispozitat e aktit të brendshëm të parashtruesit të kërkesës për Procedurat Disiplinore dhe të Ankesave. Ky konstatim i Gjykatës Themelore kishte të bënte me përbërjen e Komisionit Disiplinor, ku nuk ishte ftuar anëtari i Sindikatës së Pavarur, siç përcaktohet në dispozitën e nenit 8.1 të aktit të brendshëm të parashtruesit të kërkesës. Për më tepër, Gjykata Themelore arsyetoi se Vendimin për largim nga puna nuk e kishte marrë Menaxheri Gjeneral por Kryeshefi Ekzekutiv, në kundërshtim me nenin 8.15 të Aktit të lartpërmendur..”*
52. Punëdhënësi, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, e cila më 12 dhjetor 2017, me Aktgjykimin [Ca. nr. 1519/2017], e kishte refuzuar ankesën e punëdhënësit dhe e kishte vërtetuar Aktgjykimin [C. nr. 511/2015] e 11 nëntorit 2016 të Gjykatës Themelore, me arsyetimin se *“gjykata e shkallës së parë kishte dhënë arsye konkrete për faktet vendimtare dhe po ashtu kishte shpjeguar në mënyrë adekuate arsyet për një vendimmarrje të këtille, bazuar në dispozitat përkatëse ligjore. Për më tepër në lidhje me mos ftesën e përfaqësuesit të Sindikatës së Pavarur, Gjykata e Apelit në arsyetim të Aktgjykimit të saj kishte theksuar se *“Sipas gjetjeve të kësaj gjykate i padituri (punëdhënësi) nuk ka deponuar mjaft dëshmi për ftesën e rregullt të përfaqësuesit të sindikatës. Gjykata e shkallës së parë drejt ka vërtetuar faktet relevante në këtë çështje juridike”**
53. Ndaj Aktgjykimit të lartcekur, punëdhënësi kishte ushtruar kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, me pretendimin se përfaqësuesi i Sindikatës së Pavarur ishte i ftuar për të marrë pjesë në Komisionin Disiplinor, por i njëjti nuk kishte marrë pjesë. Më 12 prill 2018, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin [Rev. nr. 54/2018], kishte refuzuar kërkesën për revizion të ushtruar nga punëdhënësi dhe kishte vërtetuar aktgjykimet e instancave me të ulëta, me arsyetimin se: *“në këtë çështje juridike relevante është fakti se e paditura nuk ka pasur përbërje të plotë e cila ka rekomanduar menaxherit që ndaj paditësit të shqiptohet masa disiplinore e ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Sipas dispozitës së nenit 8.1 të Aktit të brendshëm të paditurës për procedurat disiplinore dhe të ankesave përbëhet nga 3 anëtarë dhe sekretari për të mbajtur procesverbalin. Kryetari i Komisionit është Drejtor i Burimeve Njerëzore [..], Drejtori i Zyrës Ligjore, një punues i Aeroportit, Kryetari i Sindikatës së Pavarur dhe Sekretari për mbajtjen e procesverbalit pa të drejtë vote. Nga provat e administruara është vërtetuar fakti se komisioni disiplinor të paditurës me rastin e shqiptimit të masës disiplinore paditësit nuk ka qenë në përbërje të plotë, pasi që ka munguar Kryetari i Sindikatës së Pavarur. E paditura pretendon si në ankesë edhe me revizion se përfaqësuesi i sindikatës ka*

*qenë i njoftuar por nuk ka marrë pjesë, mirëpo këtë fakt e paditura nuk e ka provuar me asnjë provë”.*

54. Më 30 korrik 2018, punëdhënësi, kishte parashtruar kërkesën KI109/18 në Gjykatën Kushtetuese, nëpërmjet së cilës kontestoi kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Rev. nr. 54/2018] të 12 prillit 2018, të Gjykatës Supreme, me pretendimin thelbësor se Gjykata Supreme nuk kishte arsyetuar mjaftueshëm aktgjykimin e saj dhe se kishte bërë interpretim të gabuar të Ligjit të punës nr. 03/L-212, Kontratës së punës, dhe të Rregullores për procedurat disiplinore dhe të ankesave. Në mënyrë të veçantë, punëdhënësi pranë Gjykatës Kushtetuese pretendoi se Gjykata Supreme kishte vërtetuar gabimisht faktin, ku thotë se përbërja e Komisionit Disiplinor nuk ishte e plotë, pasi që kishte munguar përfaqësuesi i Sindikatës, duke shtuar se në fakt përfaqësuesi i Sindikatës ishte i ftuar në seancën e komisionit, por nuk kishte asistuar në seancë pa asnjë arsyetim me shkrim. Më 7 nëntor 2019, Gjykata në lidhje me kërkesën KI109/18 vendosi me Aktvendim për papranueshmëri, duke arritur në konkluzionin se pretendimet e parashtruesit të kërkesës ngrenë çështje të faktit dhe të ligjit, duke shtuar se *“Vërtetimi i plotë i gjendjes faktike dhe aplikimi i drejtë i ligjit është detyrë parësore dhe brenda juridiksionit të gjykatave të rregullta dhe se Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë në rastin konkret si “gjykatë e shkallës së katërt”.*

***Analizë e rrethanave faktike dhe juridike të rastit të parashtruesit të kërkesës me ato të rastit të B. Sh-së***

55. Gjykata, duke iu rikthyer pretendimit të parashtruesit të kërkesës se Gjykata Supreme në dy raste identike ka vendosur ndryshe, vëren se aktgjykimi për rastin e B. Sh-së, ishte nxjerrë më 12 prill 2018, ndërsa në rastin e parashtruesit të kërkesës më 10 mars 2022, respektivisht pas tre (3) viteve, e njëmbëdhjetë (11) muajve. Nga përshkrimi i rrethanave faktike të dy rasteve Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës dhe B. Sh-ja, kanë qenë punëtorë të të njëjtit punëdhënës, ndaj të cilëve ishte iniciuar procedura disiplinore njëkohësisht nga Komisioni disiplinor i punëdhënësit. Ky i fundit, pasi kishte mbajtur seancë dëgjimore, më 10 nëntor 2015, kishte nxjerrë Vendimin [HR.2015-0693/10], me të cilin ua kishte ndërprerë të dyve marrëdhënien e punës. B. Sh-ja dhe parashtruesi i kërkesës, kundër vendimit në fjalë, ndaras kishin ushtruar kërkesëpadi në Gjykatën Themelore, me kërkesë për: (i) anulimin e Vendimit [HR.2015-0693/10] të 10 nëntorit 2015 të punëdhënësit; (ii) kthim në vendin e punës; dhe (ii) kompensim të pagave të porealizuara deri në skadimin e kontratës së punës.
56. Në rastin e B. Sh-së, Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit e kishin aprovuar në tërësi kërkesëpadinë, dhe pas ushtrimit të kërkesës për revizion nga ana e punëdhënësit, aktgjykimet e dy gjykatave ishin konfirmuar nga Gjykata Supreme. Ndërsa në rastin e parashtruesit të kërkesës, Gjykata Themelore, kishte aprovuar kërkesëpadinë e tij, përkitazi me anulimin e Vendimit [HR.2015-0693/10] të 10 nëntorit 2015 të punëdhënësit, dhe për kompensimin e pagave të pa realizuara, deri në datën e skadimit të kontratës, dhe kishte refuzuar kërkesëpadinë përkitazi me kërkesën për kthimin në vendin e punës. Pas ushtrimit të ankesës nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata e Apelit kishte refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e tij si të pabazuar. Më pas parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, dhe kjo e fundit, (i) kishte refuzuar kërkesëpadinë për kthim në punë, dhe kishte konfirmuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore, përkitazi me (i) aprovimin e kërkesëpadiisë për anulimin e Vendimit [HR.2015-0693/10] të punëdhënësit, dhe për (ii) kompensimin e pagave të paralizuar.
57. Gjykata, nga shtjellimet e mësipërme dhe nga analiza e konkluzioneve të Gjykatës Supreme vëren se rrethanat faktike po ashtu edhe ato juridike, të të dy rasteve duket të kenë qenë të ngjashme. Megjithatë, Gjykata rikujton se praktika gjyqësore e GjEDNj



- dhe e Gjykatës përcakton që edhe në raste kur vendimmarrja mund të jetë kundërthënëse, për çështje faktike dhe juridike të njëjta, referimi i parashtruesit të kërkesës, vetëm në një rast të vetëm nuk është i mjaftueshëm për të konstatuar se kemi të bëjmë me jokonsistencë të praktikës gjyqësore, për të vazhduar më tej me shtjellimin e tre (3) kritereve bazë, nëse divergjencat në praktikën gjyqësore janë “*të thella dhe afatgjata*”, nëse ligji vendor përcakton mekanizma të aftë për të zgjidhur divergjenca të tilla, dhe nëse ata mekanizma janë zbatuar dhe me çfarë efekti. Për më tepër, krahasimi i vetëm dy rasteve po ashtu nuk dëshmon se Gjykata Supreme megjithatë ka vendosur ndryshe dhe favorshëm për një mori individësh, të ndodhur në rrethana tërësisht të njëjta me ato të parashtruesit të kërkesës.
58. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet jurisprudencës së GjEDNj-së, e cila përcakton se është përgjegjësi e autoriteteve vendore për të organizuar sistemin juridik në atë mënyrë që të shmangen vendimet kundërthënëse, sidomos një kërkesë e tillë është më fuqishme kur kundërthëniet e praktikës gjyqësore nuk janë një incident (rast) i izoluar, por kjo jokonsistencë mund të afektojë një numër më të madh të personave që paraqiten në gjykatë (shih, GjEDNj, rastin *Famullia Greko-Katolike e Lupenit dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 129).
59. Gjykata duke iu rikthyer pretendimeve të parashtruesit të kërkesës rikujton praktikën e saj, ku kishte theksuar se megjithatë nuk mund të konstatohet jokonsistencë në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme, në krahasimin e vetëm 2 (dy) aktgjykimeve (rasteve) edhe nëse të njëjtat mund të jenë kundërthënëse. Në një rrethanë të tillë, ku parashtruesit e kërkesës i referohen vetëm një vendimi, i cili përmban konstatim dhe përfundim ndryshe nga vendimi i nxjerrë në rastin e tyre, Gjykata nuk kishte konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, përkatësisht shkelje të parimit të sigurisë juridike, si rezultat i praktikës gjyqësore jokonsistente. (shih, rastet e Gjykatës: [KI29/17](#), parashtrues *Adem Zhegrova*, Aktvendimi i 5 shtatorit 2017, paragrafi 53; [KI42/17](#), parashtrues *Kushtrim Ibraj*, Aktvendimi i 5 dhjetorit 2017, paragrafi 44; [KI107/19](#), parashtrues *Gafurr Bytyçi*, Aktvendimi i 11 marsit 2020, paragrafi 76; dhe [KI139/19](#), parashtrues *Riad Bejtullahu*, Aktvendimi i 10 nëntorit 2020, paragrafi 58).
60. Duke rikujtuar detyrimin e përcaktuar përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës që parashtruesit e kërkesës duhet t'i paraqesin Gjykatës argumentet përkatëse përkitazi me ngjashmëritë faktike dhe juridike të rasteve për të cilat pretendojnë se janë zgjidhur ndryshe nga gjykatat e rregullta, duke rezultuar në vendime kundërthënëse, Gjykata vëren se përveç dorëzimit të një rasti të vetëm, dhe që i referohet rrethanave faktike dhe juridike të ngjashme si ato të rastit të B. Sh., parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur që Gjykatës t'i paraqesë argumente shtesë, apo raste tjera që janë vendosur ndryshe nga Gjykata Supreme, dhe rrjedhimisht ta mbështesë pretendimin e tij për cenim të sigurisë juridike, si rezultat i vendimeve kundërthënëse të Gjykatës Supreme.
61. Në dritën e praktikës së vet gjyqësore, dhe të parimeve të përcaktuara nga GjEDNj-ja, në lidhje me jokonsistencën, Gjykata vlerëson se nuk është e mundur të konstatohet ekzistimi i “*dallimeve të thella dhe afatgjata*” në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme që rrezikojnë parimin e sigurisë juridike, duke u thirrur vetëm në një Aktgjykim të Gjykatës Supreme, të nxjerrë vetëm tre (3) vite, e njëmbëdhjetë (11) muaj me herët. (shih, në mënyrë analoge rastin e Gjykatës [KI29/17](#), cituar më lart, paragrafi 53).
62. Për më tepër, Gjykata konsideron se as numri i aktgjykimeve të pretenduara si kundërthënëse, dhe as periudha kohore brenda së cilës janë nxjerrë këto aktgjykime, si dhe as mënyra se si Gjykata Supreme ka vlerësuar dhe trajtuar rastin e parashtruesit të kërkesës nuk krijojnë bazë të mjaftueshme për të arsyetuar pretendimin për shkelje të



parimit të sigurisë juridike, si rrjedhojë e vendimeve kundërthënëse të Gjykatës Supreme. (shih rastin [KI29/17](#), cituar më lart, paragrafi 58).

63. Gjykata, gjithashtu rithekson se bazuar në standardet e evoluimit të praktikës gjyqësore, përsërit që vendimmarrja e gjykatave të rregullta është dinamike, dhe ajo mund ndryshojë, duke iu përshtatur rrethanave të reja si dhe duke përmirësuar administrimin e drejtësisë. Është në diskrecionin dhe autoritetin e tyre për të vlerësuar dhe interpretuar të drejtën pozitive.
64. Andaj, bazuar në të gjitha elaborimet e mësipërme, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNj-së, përkitazi me jokonsistencën e praktikës gjyqësore të Gjatës Supreme, i përkasin kategorisë së tretë (iii) të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, andaj si të tilla në baza kushtetuese i shpallë të njëjtat qartazi të pabazuara.

## **ii. Përkitazi me pretendimet e tjera**

65. Në vlerësimin e pretendimeve të tjera, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, përveç pretendimeve për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, pretendon edhe shkelje të neneve 24 dhe 46 të Kushtetutës. Megjithatë, arsyetimi i shkeljes së këtyre neneve në të vërtetë ngre çështje të procesit të rregullt gjyqësor, gjegjësisht të jokonsistencës së praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme për të cilën Gjykata sa më lart konstatoi se kërkesa në lidhje me shkeljen e kësaj të drejte kushtetuese është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese. Gjykata përsërit se vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNj-së ose ndërlihdja e tyre me një nen tjetër të Kushtetutës nuk nënkupton me automatizëm edhe shkelje të neneve të tjera të Kushtetutës dhe KEDNj-së, nëse më tej nuk argumentohet dhe shtjellohet se si dhe përse ka ardhur deri te shkelja e tyre.
66. Gjykata vazhdimisht ka theksuar se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNj-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNj, parashtruesit e kërkesave duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës: [KI175/20](#), me parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 prillit 2021, paragrafi 81; [KI166/20](#) parashtrues *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 dhjetorit 2020, paragrafi 52; [KI04/21](#), me parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 majit 2021, paragrafët 38-39).
67. Andaj sa më sipër, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen të neneve të lartcekura, i përkasin kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (a), të pretendimeve “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, andaj si të tilla në baza kushtetuese edhe këto pretendime duhet shpallur qartazi të pabazuara.

## **Përfundime**

68. Si përmbledhje, Gjykata, duke i marrë parasysh të gjitha shtjellimet dhe konstatimet e mësipërme, konkludon se: (I) pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj, për jokonsistencë në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme, i përkasin kategorisë së tretë (iii), të pretendimeve të “*pambështetura apo të paarsyetuara*” andaj si të tilla në baza kushtetuese shpallen qartazi të pabazuara; (II) pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 24 dhe 46 të Kushtetutës, i përkasin po ashtu kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (a), të pretendimeve “*të*



*pambështetura ose të paarsyetuara*”, andaj si të tilla në baza kushtetuese po ashtu shpallën qartazi të pabazuara.

69. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësinë e saj, në pajtueshmëri me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, duhet shpallur e papranueshme si qartazi e pabazuar.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 dhe 47.1 të Ligjit dhe me rregullin 59 (a) të Rregullores së punës, më 5 prill 2023, njëzëri

### **VENDOS**

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;
- III. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**

  
Remzije Istrefi-Peci



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

  
Gresa Caka-Nimani